



# DISICON

**KONFERENCË PËR  
PARANDALIMIN E DEZINFORMIMIT**

**10 DHJETOR, 2019  
PRISHTINË, KOSOVË**





# HYRJE

Dezinformimi paraqet kërcënim në rritje për integritetin e diskursit demokratik në tërë botën. Me rritjen e kërkesës për marrjen e informacioneve nga rrjetet sociale dhe interneti, diskursi publik me shpejtësi është zhvendosur në internet. Në shumë shtete, mundësia për tu përfshirë në mënyrë përmbajtësore dhe lirshëm në diskutimet publike që zhvillohen në internet është vënë në kërcënim, për shkak dezinformatave të përhapura pa dashje apo përmes kampanjave të koordinuara.

Për të kuptuar më mirë ndërlikimet, sfidat dhe masat e mundshme parandaluese në luftimin e dezinformimit, ekipi i NDI-së në Kosovë ka orientuar programet aktuale në drejtim të përpjekjeve për të angazhuar palët kryesore në zhvillimin e një analize mbi gjendjen aktuale të mjedisit të informimit në Kosovë. DISICON është një platformë ndër-sektoriale që do të ofrojë diskutime që synojnë të ekzaminonjë format në të cilat dezinformimi manifestohet në Kosovë dhe të nxis veprime për të parandaluar dhe luftuar dezinformimin në internet.



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

## GJETJET E HULUMTIMIT TË INSTITUTIT KOMBËTAR DEMOKRATIK

Në ndjekje të trendeve të përgjithshme sociale, diskursi politik në të gjithë botën është bartur në internet. Meqënëse ky transformim ka ndodhur, më nuk mund të merret si e mirëqenë se informata që përbën bazën e diskursit politik është e bazuar në fakte dhe nuk është e njollosur me qëllime dashakeqe. Dezinformimi është formë e fjalimit të dëmshëm, i përkufizuar si informatë e rreme ose e pasaktë që krijohet ose shpërndahet qëllimisht dhe me qëllimin e qartë që të mashtrjë dhe shkaktojë dëm, zakonisht me motive politike, financiare, psikologjike ose shoqërore. Qeveritë autoritare dhe aktorët joliberalë, ndër të tjerë, e kanë bartur dezinformimin në arenën e internetit, duke zhvilluar një gamë teknikash për të prodhuar dhe shpërndarë shpejtë dezinformata tek audienca të gjera, duke kërcënuar kështu aftësinë për të zhvilluar diskurs politik të bazuar në fakte dhe informata të sakta. Në kontekst të sotëm, çdo përpjekje për të nxitur një demokraci të shëndetshme dhe përparimtare duhet të përfshijë përpjekje të bashkërenduara për të mbrojtur integritetin e mjedisit të informacionit.

Kërcënimi i dezinformimit ndaj diskursit të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm politik rrezikon shtetet nga e gjithë bota, përfshirë Kosovën. Kremlini ka mbështetur një fushatë dezinformimi për kontroll në rajon dhe përpjekjet e saj mund të shtrihen tutje në Kosovë.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Informata të siguruar nga një dëshmi në kongres, në dispozicion këtu: Polyakova, Alina. “Përpjekjet e SHBA për të luftuar dezinformimin rus dhe ndikimin qëllimkeq.” Brookings. Brookings, 10 korrik 2019 <https://www.brookings.edu/testimonies/u-s-efforts-to-counter-russian-disinformation-and-malign-influence/>



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

Bazuar në historinë e vendit si një vend jo stabil dhe i dalë nga konflikti, duke pasur parasysh përçarjet e thella partiake dhe tensionet e kamotshme etnike, Kosova dhe qytetarët e saj mund të jenë mjaft të cenueshëm ndaj dezinformimit.

## MJEDISI I INFORMACIONIT NË KOSOVË

Një identifikim kualitativ i mjedisit të informacionit në Kosovë i realizuar nga NDI në mars 2019 konstatoi se ekziston një treg i fuqishëm vendor për dezinformim. Intervistat me akterët kryesorë nga partitë politike, shoqëria civile, media, industria e teknologjisë dhe qeveria zbuluan se besohet se akterët politikë nga i gjithë spektri përdorin portalet e lajmeve si vende dezinformimi dhe rregullisht prodhojnë dezinformata, duke u përpjekur të arrijnë përfitime shkurtpamëse politike dhe të lëkundin bindjet e elektoratit. Gazetarët, të cilët zakonisht përballen me mundësi të kufizuara për të siguruar të ardhura për jetesë, lejojnë artikujt nxitës të partive si mënyrë për të siguruar të ardhura në mënyrë të shpejtë. Kosova gjithashtu vuan nga një industri relativisht jotransparente e mediave, ku gazetarët dhe organizatat e lajmeve nuk janë të detyruara t'i publikojnë raportet e hollësishme të financimit. Kjo mungesë transparence, e kombinuar me mungesën e financimit të agjencisë rregullative dhe dëshmitë anekdotale që sugjerojnë se gazetarët rregullisht përballen me ngacmim dhe frikësim, krijon një bazament për dezinformim, të cilën akterët qëllimkëqinj mund ta shfrytëzojnë për synime destabilizuese. Nga ana pozitive, trendet e konsumit të informacionit nga elektorati zbulojnë një nivel të lartë të pluralizmit të burimeve të mediave dhe një nivel të arsyeshëm të rrjedhshmërisë së mediave.



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

Vlerësimi tregoi gjithashtu se cilësia dhe sasia e lajmeve të prodhuara në Kosovë në gjuhën serbe është e kufizuar, dhe se kjo krijon një mjedis të shkëputur të informacionit midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Kjo nënkupton se janë dy fronte efektive të dezinformimit që duhet marrë parasysh dhe trajtuar për të kapur në tërësi mjedisin e informacionit në Kosovë.

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Pas vlerësimit të marsit 2019, NDI realizoi tre nivele shtesë të hulumtimit për të strukturuar mjedisin e dezinformimit në Kosovë. Me shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare në tetor 2019, NDI kontrakttoi një kompani amerikane për të analizuar të dhënat nga Twitter, Facebook dhe burime të mediave në internet për t'i përcjellë mesazhet politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Ky hulumtim sasior skanoi përmbajtjet publike nga mijëra përdorues të mediave sociale dhe qindra faqe në internet për të identifikuar pranitë e robotëve (bots) ose lajmeve të fabrikuara qëllimshëm, dhe të gjurmojnë sesi dezinformatat e identifikuar kanë qarkulluar nëpër llogaritë dhe faqet e monitoruara. Përveç kësaj, NDI ka kryer monitorim të portaleve të mediave tradicionale në internet dhe llogarite e tyre në mediat sociale, veçanërisht duke përcjellë storiet që janë dëshmuar të jenë dezinformuese gjersa kalonin nga mediat sociale te ato kryesore. Bazuar në analizën e brendshme të më shumë se 2,800 postimeve në media sociale dhe artikujve të lajmeve, NDI vlerësoi cilësinë e mjedisit të informacionit gjatë periudhës së zgjedhjeve, duke distiluar rolin që kishin mediat dhe partitë kryesore, dhe duke hulumtuar edhe prejardhjen e mundshme të dezinformimit edhe pasojat në diskursin e përgjithshëm politik.



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

NDI i shoqëroi këto përpjekje bashkë me hulumtimet cilësore të opinionit publik përmes një serie prej 12 grupesh të fokusit me pjesëmarrës nga gjashtë rajone, nga komunitetet shqiptare dhe serbe të Kosovës. Ky hulumtim kishte për qëllim të kuptonte më mirë përdorimin e mediave nga elektorati dhe edukimin mediatik, si dhe në çfarë mënyre dezinformimi ndikon në synimet politike.

## GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT

Kjo metodologji katër pjesëshe krijoi një të kuptuar të mjedisit dezinformues të Kosovës, duke përfshirë raste të qarta dezinformimi që janë përdorur në periudhën zgjedhore për të lëkundur elektoratin, ndonëse natyra dhe shpeshtësia e dezinformimit ndryshonte në masë të madhe sipas gjuhës së përmbajtjes.

- **Të gjitha partitë politike u preken nga sulmet e dezinformative në lajmet në gjuhën shqipe gjatë periudhës së zgjedhjeve.** Në të gjithë gamën e burimeve të gjuhës shqipe të monitoruara gjatë fushatës, të gjitha rastet e dezinformimit dhe manipulimit të përmbajtjes kanë ndodhur në kontekst të shtyrjeve politike midis partive të ndryshme që garonin në zgjedhje. Monitorimi në shqip u krye kryesisht në Facebook dhe portalet në internet, meqë përdorimi i Twitter ishte minimal. Hulumtimi identifikoi raste të shumta të fotografive, artikujve, sondazheve të opinionit publik dhe videove të dokumentuara që ose synonin të shpifnin për kandidatët për kryeministër dhe partitë e tyre ose të promovonin një parti në veçanti. Sulmet shpifëse u regjistruan kundër pothuajse të gjitha partive dhe kandidatëve, veçanërisht kundër Kadri Veselit, Vjosa Osmanit, dhe Albin Kurtit.



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

- **Dezinformatata në periudhën zgjedhore nuk ishte rezultat i një fushate të koordinuar mirë ose të drejtuar ndaj një caku. Disa raste me gjasë mund të kenë qenë keqinformim - informata të pasakta apo të gabuara që nuk kishin për qëllim shkaktimin e dëmit – si pasojë e gazetarisë së cilësisë së ulët, duke përfshirë verifikimin e kufizuar të fakteve.** Monitorimi nga zyra i NDI zbuloi se një pjesë e vogël e portaleve të lajmeve në internet ose faqeve të Facebook ishin burimet fillestare të përpjekjeve për dezinformim, pavarësisht se disa storie u ndanin gjerësisht në platformat dhe faqet e tjera në gjuhën shqipe. Shumë prej faqeve që ishin burim i dezinformimit ishin ose zyrtarisht partiake ose kishin përafrim me një parti në veçanti. Për shembull, Horizonti24 dhe Ngjarjeditore ishin faqe që publikuan dezinformata kundër partive të veçanta politike. Shumica e tyre shfaqën disa prej treguesve bazë të burimeve të dezinformimit, si të pasurit administratorë pa adresë të regjistruar ose me adresë në vende të huaja (Francë, Austri, Shtete të Bashkuara), ose ndryshonin emrin e faqeve disa herë brenda një kohe të shkurtër. Sidoqoftë, kishte pak indikacione të përdorimit të automatizuar të robotëve (bots) të dezinformimit për të prodhuar ose shkëmbyer dezinformata, si dhe pak indikacion se ka pasur fushatë të qartë dhe të koordinuar dezinformimi, e sponsorizuar nga një entitet i huaj. Këto gjetje ishin në përputhje me hulumtimin fillestar diagnostik të NDI në lidhje me manifestimin e dezinformimit në mediat në gjuhën shqipe para se të zhvillohej monitorimi i zgjedhjeve. Kjo demonstroi që dezinformata në përgjithësi është e shtyrë nga njerëzit, dhe mund të përfshijnë gazetarë që përballen me vështirësi ekonomike, si dhe nënvizoi kostot e ulëta vendore për të hyrë në prodhim të dezinformatave.





# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

- **Vlerësimi i gjendjes i informimit në të gjitha burimet në gjuhën serbe zbuloi raste shqetësuese, duke përfshirë përpjekje të koordinuara të dezinformimit që rrezikojnë nxitjen e tensioneve etnike.** Në përputhje me hulumtimin cilësor se si serbët kosovarë konsumojnë lajmet e tyre, Twitter shfaqet si shumë më i rëndësishëm në formimin e peizazhit të informacionit. Gjatë periudhës së fushatës, hulumtimi identifikoi disa përpjekje të qarta për të përhapur storie të falsifikuara dhe ish-in tërësisht partiake. Dy temat kryesore të lajmeve dhe fotove të fabrikuara janë përqendruar në përpjekjet për të nxitur armiqësi ndëretnike, siç është “zbulimi”, pa asnjë dëshmi, se grupet ekstremiste shqiptare të Kosovës po përgatiteshin të kryenin dhunë masive kundër serbëve të Kosovës në veri pas zgjedhjeve, dhe pretendimi se të gjithë anëtarët e partive serbe, përveç të Listës Serbe, fshehtazi minonin interesat e serbëve të Kosovës për përfitimin e tyre personal. Përpjekjet ishin dukshëm më të qarta dhe të koordinuara, ku secili shembull i dezinformatës tregonte një plan koherent të ekzekutuar për një qëllim specifik. Përderisa shumë portale të lajmeve online me bazë në Serbi u identifikuan si burime kryesore të përmbajtjes origjinale të dezinformimit, analiza e automatizuar identifikoi një fluks të llogarive të reja në Twitter, me bazë në Serbi, të cilat u hapën pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj dhe shpërbërjes së Kuvendit. Hulumtimet zbuluan se qindra llogari në Twitter postuan në lidhje me zgjedhjet disa herë në ditë dhe se një e treta e këtyre llogarive ishin të automatizuara. Analiza e ekspertëve konkludoi se ky është indikacion i përdorimit të madh të robotëve (bots). Përdorimi i robotëve (bots) gjithashtu nënkupton që burimet ishin të dedikuara nga një entitet i caktuar për të rritur enkas vizibilitetin e artikujve të dyshimtë dhe nxitës tek serbët e Kosovës dhe për të krijuar ndjenjën se kishte një bisedë “reale” mbi këto tema të fabrikuara qëllimshëm.



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

Duke i pasur parasysh këto gjetje, ishte po aq e rëndësishme që të kuptojmë cenueshmërinë e qytetarëve ndaj dezinformimit dhe qëndrimet e tyre ndaj dezinformimit.

- **Edhe pjesëmarrësit shqiptarë edhe ata serbë të Kosovës në grupet e fokusit të NDI treguan se burimet që zakonisht përdoren për të konsumuar informata përputhen mjaft me kanalet që pranonin më së shumti dezinformata.** Shumica e shqiptarëve të Kosovës kanë cekur përdorimin e Facebook dhe portalet në internet për lajmet e tyre, ndërsa serbët e Kosovës ishin më me gjasë që të përdorin Twitter dhe burimet e lajmeve me bazë në Serbi.
- **Përkundër kësaj lidhjeje, grupet e fokusit treguan se pjesëmarrësit që përdorin burimet e të dy gjuhëve kishin një kuptim të mirë të asaj se si duket dezinformimi.** Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit asoconin titujt mashtrues dhe kurthet për klikime si flamuj të kuq për dezinformim, gjë që është veçanërisht e rëndësishme meqenëse që të dyja ishin tipare të shumicës së rasteve të dezinformimit të vërejtur gjatë periudhës së fushatës. Të anketuarit gjithashtu demonstrojnë aftësi për të vënë në pikëpyetje integritetin e burimit të lajmit kur deshifronin nëse një artikull i caktuar ishte i rremë apo jo. Në grupe të fokusit, serbët e Kosovës nga veriu ishin më të mirë në identifikimin e dezinformimit sesa serbët e Kosovës në Graçanicë.
- **Përkundër këtyre gjetjeve pozitive, ushtrimet e kryera në grupe të fokusit gjithashtu zbuluan se pjesëmarrësit janë më pak rezistues ndaj dezinformimit se që e perceptojnë vetë.** Të gjithë pjesëmarrësit kishin vështirësi të mëdha për



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

t'i identifikuar rastet më të avancuara ose të sofistikuara të dezinformimit, siç janë videot e manipuluar, që është indikacion i një hapësire për përmirësim për të shtuar rezistencën e publikut ndaj dezinformatave. Pjesëmarrësit, veçanërisht gratë, që marrin lajme kryesisht nga interneti, nuk ishin gjithmonë në gjendje t'i njohin burimet e besueshme të informacionit dhe janë ende të cënueshëm ndaj dezinformimit.

- **Hulumtimi në grupe të fokusit tregoi se dezinformimi në fushata zgjedhore ishte i pasuksesshëm në ndikimin e synimeve të votimit.** Pavarësisht që Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës ishin cak i disa storieve shpifëse e të manipuluar, shpeshherë duke përfshirë konjektura serioze dhe të dëmshme, këto parti performuan më së miri gjatë zgjedhjeve. Sidoqoftë, grupet e fokusit zbuluan se dezinformimi në baza gjinore është veçanërisht i vështirë për t'u luftuar nëse i forcon stereotipet ekzistuese gjinore, të cilat mund të zvogëlojnë edhe më shumë pjesëmarrjen politike të grave.
- **Kosovarët janë mjaft të shqetësuar me dezinformimin dhe dëshirojnë të shohin që udhëheqësit e tyre marrin veprime për ta parandaluar atë.** Shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusit shprehën pesimizëm për të ardhmen për sa i përket dezinformimit; pjesëmarrësit e konsideruan dezinformimin si “të dëmshëm” dhe besojnë se përdoret për t'i shpërqendruar nga shqetësimet ditore të njerëzve - korrupsioni, arsimit, punësimi. Pjesëmarrësit serbë të Kosovës ishin veçanërisht të shqetësuar se dezinformimi mund të përbëjë kërcënim real për sigurinë personale, si pasojë e cënueshmërisë së komunitetit ndaj konfliktit ndëretnik. Të gjithë pjesëmarrësit shprehën një dëshirë të qartë për veprim për të



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

eliminuar dezinformimin, ku serbët e Kosovës shfaqnin urgjencën më të madhe. Ata i bënë thirrje qeverisë dhe mediave të Kosovës të zbatojnë masa konkrete për të adresuar dezinformimin për t'i mbrojtur sistemet e saj demokratike dhe debatet publike.

## MBËSHTETJA E INTEGRITETIT TË INFORMACIONIT NË KOSOVË

Duke pasur parasysh si më sipër, Kosova ka shumë nevojë për një përpjekje të përbashkët për të parandaluar dezinformimin e mëtutjeshëm dhe ndikimin e saj degradues në diskursin demokratik të Kosovës. Rreziqet që lidhen me mosveprimin ndaj dezinformimit janë të mëdha. Ndarjet etnike të Kosovës dhe konsumi i ndarë i medias lënë të kuptohet se një fushatë e koordinuar e dezinformimit do të mund të rinxiste armiqësi etnike. Partitë politike që vazhdojnë të përdorin dezinformim ndërsa mëtojnë poena jetëshkurtër politikë, mund të krijojnë një opinion publik që është edhe më i zhgënjyer me aftësinë e aparatit politik për të kapur në mënyrë të duhur frustrimet dhe adresuar shqetësimet e tyre. Cenueshmëritë e qytetarëve ndaj dezinformimit, veçanërisht nga fushata të sofistikuara dhe të koordinuara të dezinformimit, mund të rrezikojnë trajektoren e Kosovës në lidhje me progresin e saj liberal demokratik dhe aspiratat për anëtarësim në institucionet euroatlantike.

Tani mund të merren hapa për të ndërtuar rezistencën e mjedisit informativ të Kosovës dhe për t'i luftuar përpjekjet e ardhshme të dezinformimit. Me krijimin e një publiku me nivel të lartë të edukimit mediatic dhe pluralizmin e burimeve të mediave, liderët e Kosovës, të shoqërisë civile, qeverisë, partive politike dhe mediave, duhet të mblidhen për të parandaluar furnizimin dhe kërkesën e dezinformimit, duke identifikuar



# DEZINFORMIMI NË KOSOVË

gjithashtu përgjigjet efektive ndaj autorëve të tyre. Secili ka rol në adresimin e këtij problemi në Kosovë - nga partitë politike, të cilat duhet të bëjnë zotime për të shmangur përdorimin e dezinformimit kundër kundërshtarëve politikë; shoqëria civile, e cila duhet të punojë me mediat në kontrollimin e fakteve dhe të sigurojë integritetin e mbulimit të lajmeve; qeveria dhe kuvendi, të cilat mund të marrin në konsideratë mekanizmat institucionalë dhe ligjorë për të mbështetur këtë përpjekje. Duke punuar së bashku, ata mund të promovojnë analiza kritike tek qytetarët dhe pajtimin ndëretnik për të ndërtuar rezistencë ndaj dezinformimit që përkeqëson tensionet etnike apo promovon dhunë. Në këtë kohë, është e domosdoshme që angazhimi dhe strategjia përkatëse për të parandaluar dezinformimin në Kosovë dhe për të zvogëluar sfidat që ajo i paraqet demokracisë t'i përfshijë të gjithë aktorët që kontribuojnë në mjedisin e informacionit në Kosovë, duke përfshirë komunitetin e teknologjisë dhe mediave, partitë politike, degët e legjislativit dhe ekzekutivit, organizatat e shoqërisë civile dhe elektoratin e përgjithshëm.

*Ky raport dhe hulumtimi i Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) në Kosovë është bërë i mundur përmes mbështetjes së Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e USAID, apo individëve të organizatave të sipërpërmendura.*

*Të drejtat e autorit© Instituti Kombëtar Demokratik 2019. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesë të këtij raporti mund të riprodhohen dhe/ose përkthehen për qëllime jotregtare, me kusht që NDI ceket si burimi i materialit dhe pajiset me kopje të përkthimeve.*



# AGJENDA

**09:30 - 10:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve

**10:00 - 10:20** Hapja e programit

**Shari Bryan**, Zëvendës Presidente e Institutit Kombëtar Demokratik  
**Philip S. Kosnett**, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës  
në Kosovë

## **10:20 - 10:30 Të gjeturat nga hulumtimi i NDI-së: A është Kosova e mbrojtur nga dezinformimi?**

Prezantimi i të gjeturave kryesore të NDI-së nga analizimi i mjedisit të informacionit gjatë periudhës së fushatës në zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës të mbajtura në tetor 2019. Me mbështetjen e një kompanie me qendër në SHBA e cila është e specializuar në analizimin e rrjeteve, NDI ka monitoruar një laramani të llogarive publike në Facebook dhe në Twitter duke i skanuar ato për shenja të hershme të përpjekjeve dhe mjeteve për shtrembërim të informacionit. Analiza manuale në platforma të ndryshme në internet shqyrtoi se si palët e ndryshme shpërndajnë keqinformim ose dezinformata në 'portale të lajmeve', në llogari të Twitter dhe Facebook, duke i lidhur mesazhet nga llogaritë e tyre me platforma tjera relevante të përdorura nga elektorati i Kosovës. Më në fund, NDI zhvilloj një seri fokus grupesh për të matur perceptimet dhe disponimin e elektoratit, si dhe ndikimi që kishin tek votuesit rrjedha e informacionit gjatë fushatës dhe përpjekjet për dezinformim.

**Valon Kurhasani**, Drejtor i Programit, NDI Kosovë

**10:30 - 12:00** Panel diskutimi I



# AGJENDA

## **Demokracia dhe Proceset Politike nën kërcënim: Si dezinformata kërcënon integritetin e informacionit?**

Fokusi në trajtimin e çështjes së dezinformimit digjital është rritur në mënyrë eksponenciale pasi është përdorur për të ndërhyrë në procese të rëndësishme politike, dhe ka kërcënuar demokracitë në të gjithë botën. Përdorimi i shtuar i teknologjisë në shpërndarjen e informacionit, paraqet sfida për qytetarët që të kuptojnë se çfarë është informacion faktik ose jo, dhe a duhet të përdorin këtë informacion për të marrë vendime të informuara demokratike. Ky prezantim nga paneli do të shqyrtojë dobësitë ndaj dezinformatave, veçanërisht në vende me demokraci në konsolidim të cilat mund të jenë më të rrezikuara në zbulimin dhe trajtimin e këtyre kërcënimeve. Panelistët do të ofrojnë një kornizë mbi dezinformimin për të eksaminuar mënyrat se si ndikon në integritetin e informacionit në proceset politike.

**Hapja e panelit dhe moderator:** Agron Bajrami, Kryeredaktor në Koha Ditore

**Panelists:** Dorka Takacsy, Analiste në Institutin e Kapitalit Politik

Miroslava Sawaris, Hulumtuese në Institutin e Politikës së Sigurisë Globale

Matt Bailey, Këshilltar i lartë për Inovacion dhe Teknologji në Demokraci, NDI

### **12:00 - 12:30 Disi-Story: Dezinformimi në Serbi, ndikimi dhe pasojat**

Marko Ivkovic, Drejtor Rezident në NDI Serbi

### **12:30 - 13:30 Dreka**

### **13:30 - 14:00 Disi-Story: Mësimet të nxjerra nga Maqedonia Veriore**

Filip Chaparoski, Menaxher i Lartë i Programit në NDI Maqedoni Veriore



# AGJENDA

## 14:00-14:30 Ndikimi i dezinformimit në komunitetin Serb

Ky sesion ka të bëjë me një përmbledhje të lajmeve të mediave me bazë në Kosovë në gjuhën serbe. Panelistët do të diskutojnë dhe ilustronë nivelin e ekspozimit ndaj dezinformatave dhe pasojave të tij në komunitetin serb në Kosovë

**Hapja e panelit dhe moderatore:** Jovana Radosavljević, Drejtore Ekzekutive në Iniciativen e Re Shoqërore

### **Panelistët:**

**Goran Avramovic**, Kryeredaktor në Radio KIM

**Darko Dimitrijević**, Kryeredaktor në Radio Gorazhdeci

## 14:30 - 16:00 Panel diskutimi II

### **Ndërtimi i qëndrueshmërisë në epokën e dezinformimit**

Ky sesion do të shqyrtojë se si të trajtojmë dhe përgjigjemi ndikimeve politike dhe sociale të dezinformimit në demokracitë e reja. Panelistët do të diskutojnë rolin e institucioneve në hartimin e politikave për të fuqizuar qëndrueshmërinë demokratike. Do të ekzaminojnë rolin e partive politike, mediave dhe shoqërisë civile për t'i adresuar dobësitë në fushën e informacionit dhe për të krijuar një agjendë kundër dezinformimit. Shembuj nga zgjedhjet e fundit në Kosovë, do të ndahen për të ilustruar llojet e dezinformatave të pranishme në Kosovë, të cilat do të provokojnë diskutimin mbi mjetet e nevojshme për të parandaluar dhe luftuar këtë fenomen.





# AGJENDA

**Hapja e panelit dhe moderatore:** Fitore Rexhepi, Redaktore në RTK

**Panelistët:**

**Besnik Bislimi**, Nënkryetar në Vetëvendosje

**Lutfi Haziri**, Nënkryetar në LDK

**Memli Krasniqi**, Nënkryetar në PDK

**Ardian Gjini**, Nënkryetar në AAK

The background is a solid purple color. There are several abstract shapes: a large, light purple shape in the top right corner, a smaller teal shape with a yellow circle inside it, and another teal shape with a yellow circle inside it in the bottom left corner.

FOLËSIT



## SHARI BRYAN

*Zëvendës Presidente e Institutit Kombëtar Demokratik*

Shari K. Bryan është zv. Presidente e NDI. Znj. Bryan ka qenë aktivisht e përfshirë në fushën e juridikut, zhvillimit ndërkombëtar dhe punë të jashtme që nga viti 1988. Ajo ka drejtuar vlersime dhe misione në më shumë se 30 shtete, gjatë punës së saj me NDI, dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në promovimin e programeve për ndihmë demokratike në Afrikë; konceptimin dhe organizimin e projekteve mbi financimin e partive politike; qeverisja dhe HIV/AIDS dhe ngritjen e rolit të legjislaturës në mbikqyrjen e industrive të minierave. Para që të i bashkangjitej NDI-së, Shari Bryan ka shërbyer si avokate në territorin e mbrojtur nga OKB, Palau, ku ajo punoi në negocimin e Kompaktit të Shoqatës së Lirë në 2004. Gjithashtu ka punuar si avokate në qeverinë e SHBA-ve dhe ka shërbyer me Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID).

## PHILIP S. KOSNETT

*Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë*



Philip Kosnett është Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës. Detyra më e fundit e Ambasadorit Kosnett ishte fillimisht si zëvendës-shef i misionit dhe pastaj i ngarkuar me punë të përkohshme në Ankara, Turqi, prej vitit 2016-2018. Pjesa më e madhe e karrierës së Ambasadorit Kosnett është përqendruar në bashkëpunim ndërkombëtar për siguri dhe pajtim politik. Ai ka shërbyer si Zëvendës-shef i Misionit në Uzbekistan dhe në Islandë; si dhe në pozita të zyrtarit politik, politik-ushtarak dhe ekonomik-komercial në Afganistan, Irak, Kosovë, Holandë, Japoni dhe Turqi. Pozitat në Uashington përfshijnë shërbim në by-

ronë e Departamentit të Shtetit për çështje evropiane, në byronë kundër terrorizmit, byronë politike-ushtarake, byronë për inteligjencë dhe hulumtime, si dhe në Qendrën Operative 24-orësh të Departamentit të Shtetit. Ambasadori Kosnett ka marrë shumë çmime të larta të nderit dhe çmime të merituar të nderit nga Departamenti i Shtetit, si dhe është nderuar me Medaljen për shërbim të jashtëzakonshëm civil nga Zyra e Sekretarit të Mbrojtjes dhe me Medaljen për shërbim të jashtëzakonshëm civil nga Departamenti i Armatës. Ambasadori Kosnett ka diplomuar në vitin 1982 në Harvard dhe ka punuar si dizajner i lojrave në Nju Jork dhe si mësimdhënës në Japoni para se t'i bashkohej Shërbimit për Punë të Jashtme.

## **VALON KURHASANI**

*Drejtor i Programit në NDI Kosovë*

Valon Kurhasani është Drejtor i Programit në NDI Kosovë. Ai ka më shumë se 17 vjet përvojë në forcimin e sistemit demokratik dhe fuqizimin e shoqërisë civile. Ai është pjesë e iniciativës NDI Rajonale për Partitë Politike në hartimin e programeve të udhëheqjes dhe forcimit demokratik për partitë politike nga Ballkani Perëndimor.

Valoni është profesorë i Shkencave Politike në Universitetin e Londrës nën drejtimin akademik të LSE - Riinvest College. Ai mori gradën Master në Menaxhim dhe Politika Publike nga Universiteti i Londrës, SOAS dhe gradën Bachelor në Administratën Publike dhe Shkencat Politike nga Universiteti i Prishtinës.





## **AGRON BAJRAMI**

*Kryeredaktor në Koha Ditore*

Agron Bajrami u bë kryeredaktor i Koha Ditore në shtator 2004, pas 10 viteve punë si gazetar dhe redaktor në kompaninë Koha Media. Z. Bajrami ka shkruar gjithashtu komantarë për gazetatat amerikane, gjermane dhe franceze dhe shtypin rajonal, si për (Malin e Zi, Shqipërin, Maqedonin, Sllovenin, Serbin).

Që nga viti 2003, ai është gjithashtu anëtar i Komisionit për Politikën Radio-Televizive, i kryesuar nga Erhard Busek dhe Ellen Mickiewicz. Z. Bajrami është gjithashtu anëtar i bordit të Këshillit të Shtypit të Kosovës dhe anëtar i zgjedhur i Bordit të Organizatës së Mediave të Evropës Juglindore (SEEMO). Z. Agron Bajrami u diplomua në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Prishtinës, në 1991.



## **DORKA TAKACSY**

*Analiste në Institutin e Kapitalit Politik*

Dorka ka të përfunduar studimet Bachelor në Biznes Ndërkombëtar nga Shkolla e Biznesit në Budapest dhe Universiteti Picardy Jules Verne. Kurse studimet Master i përfundoi në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Evropës Qendrore dhe studioji në Institutin e Gjuhëve, Pushkin në Moskë dhe në Universitetin George Mason në Washington DC. Ndër të tjera, ajo fitoi përvojë profesionale, në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes në DC dhe Parlamentin Evropian. Në punën e saj si analiste në Institutin Kapital Politik, ajo përqendrohet në ndikimin autoritar në regjionin e Evropës Qendrore, dhe veçanërisht në institucione që e kërkojnë ndikimin rus.

## **MIROSLAVA SAWARIS**

*Hulumtuese në Institutin e Politikës së Sigurisë Global*



Miroslava Sawaris është hulumtuese në ekipin e Komunikimit Strategjik në Institutin e Politikave GLOBSEC.

Ekspertiza e saj ka të bëjë me analizën e operacioneve të informacionit dhe fushatave dezinformuese, me një fokus të veçantë në ndikimin e këtyre veçorive keqdashëse në proceset elektorale dhe institucionet demokratike në Evropë, veçanërisht në Grupin Visegrad.

## **MATT BAILEY**

*ëshilltarë i lartë për Inovacion dhe Teknologji Demokratike në NDI*



Matt Bailey shërben si këshilltar i lartë për inovacion dhe teknologji demokratike në NDI, ku punon për një grup të gjerë çështjesh që nga dezinformimi dhe siguria në internet deri tek teknologjia qytetare dhe inovacioni komunal.

Para se të angazhohej në NDI, Matt ishte një nëpunës civil në Zyrën e Shefit për Informacion të Shteteve të Bashkuara nën dy presidentë. Derisa ishte në Shtëpinë e Bardhë, Matt ishte pjesë e ekipeve që themeluan iniciativat e para për hapjen dhe publikimin e të dhënave legjislative për qeverinë amerikane, drejtuan pjesëmarrjen e saj në Partneritetin e Qeverisë së Hapur dhe udhëheqi ekipin e zyrës për politika të shefit të informacionit. Matt ka përfunduar studimet Master në Letërsinë Angleze nga Universiteti Georgetown.

## MARKO IVKOVIĆ

*Drejtor Rezident në NDI Serbi*



Marko Ivković është drejtori aktual i Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) Serbi. Ivković më parë shërbeu në NDI Moskë dhe NDI Kiev dhe ka mbështetur programet e NDI-së për 10 vjet në Ballkan, Evropë dhe Azi. Ivković mbikëqyr punën në NDI Serbi e cila mbështet procesin legjislativ dhe proceset zgjedhore si dhe punën me liderët politik dhe civil, vëzhgues të zgjedhjeve dhe anëtarë të Parlamentit. Përveç kësaj, Ivković menaxhon gjithashtu programet rajonale që mbështesin përpjekjet e liderëve politik dhe të shoqërisë civile për të identifikuar dhe ekspozuar dezinformimin dhe propagandën, për të luftuar trendet antidemokratike dhe për të fuqizuar diskursin politik demokratik në Ballkanin Perëndimor.

## FILIP CHAPAROSKI

*Menaxher i Lartë i Programit në NDI Maqedoni Veriore*



Filip Chaparoski është Menaxher i Lartë i Programit në NDI Maqedoni Veriore, me përvojë mbi 15 vjeçare duke punuar për demokraci dhe programe qeverisjeje, përfshirë shoqërinë civile, media, parlament dhe zgjedhje. Ai ishte i përfshirë në organizimin e debateve për kandidatët për zgjedhjet presidenciale, parlamentare dhe lokale, dhe në administrimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Ai është një avokues për pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe ka ofruar asistencë dhe konsulencë për mbi pesëdhjetë iniciativa qytetare, lëvizje qytetare dhe organizata që kanë pë qëllim ndryshimin për të mirën publike. Ai ka të përfunduar studimet Master në Studime Evropiane nga Universiteti Sussex (MB) dhe Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci nga Universiteti Ndërkombëtar Schiller (SHBA).



## **FITORE REXHEPI**

*Redaktore në RTK*

Fitore Rexhepi është redaktore dhe prezantuese e programit televiziv 'Imazh' në Radio Televizionin e Kosovës, RTK.

Znj. Rexhepi ka punuar si gazetare dhe prezantuese në RTK që nga viti 2004. Ajo ka të përfunduar studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fakultetin Juridik, dhe Bachelor në Shkenca Politike nga Universiteti i Prishtinës.



## **BESNIK BISLIMI**

*Nënkryetar në Vetëvendosje*

Besnik Bislimi është nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje. Bislimi ka shërbyer si deputet i Parlamentit për një mandat (2014 - 2016). Ai ka përfunduar studimet për Analizën e Makroekonomisë në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Universitetin e Zagrebit gjatë viteve 1990-1994. Ai ka përfunduar studimet e doktoratës në Makroekonomi, specializimin në financat publike nga Universiteti Freiberg në Gjermani në shkurt 2005.

Gjithashtu, Bislimi mori pjesë përkatër muaj si përfitues i bursës në Andrew Young School për studimin e politikave në Universitetin Georgia në Atlanta në vitin 2008.





## **LUTFI HAZIRI** *Nënkryetar në LDK*

Lutfi Haziri është Kryetar i Komunës së Gjilanit dhe nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Haziri ka shërbyer si deputet i Parlamentit për një mandat dhe ishte Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Kosovës për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Jorezidente dhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal. Ai ka kryesuar delegacionin e Kosovës në bisedimet për statusin politik të Kosovës me Serbinë në Vjenë në shkurt 2006. Haziri mori një diplomë në menaxhment nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, çertifikata nga Universiteti Georgetown, Universiteti i Kolorados, një diplomë nga Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara (USIP) si dhe njohje të tjera nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.



## **MEMLI KRASNIQI** *Nënkryetar në PDK*

Memli Krasniqi është nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës. Krasniqi ka shërbyer si deputet i Parlamentit për një mandat dhe ishte Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2014-2017) dhe Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2011-2014). Ai ka përfunduar studimet Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrim Publik në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës dhe Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Shkolla London e Ekonomisë dhe Shkencave Politike. Krasniqi është kandidat për doktoraturë në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Instituti për Histori.



## **ARDIAN GJINI**

*Nënkryetar në AAK*

Ardian Gjini është Kryetar i Komunës së Gjakovës dhe nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Gjini ka shërbyer si deputet për dy mandate (2007-2014) dhe si Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ai ka përfunduar studimet në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe studime Evropiane në Universitetin e Kent në Canterbury.



## **GORAN AVRAMOVIĆ**

*Kryeredaktor në Radio Televizionin Kim*

Goran Avramović ka lindur në Kragujevac. Avramović është kryeredaktor i Radio Televizionit Kim nga Çagllavica që nga viti 2013 si dhe kryeredaktori i Radio KIM, Çagllavica.

Ai është korrespondent për disa revista kombëtare dhe vendase si Svetlost, Pogledi, Fakk, Glas juga, Politika, etj. Avramović është kontribues për RTS, TV B92, TV PINK, TV FOX, TV AVALA, 24 FRANC dhe TV 5 (FRANC). Goran ka përfunduar studimet Bachelor në Kolegji Junior për Organizim dhe Sistem Informatik Kompjuterik.



## **JOVANA RADOSAVLJEVIĆ**

*Drejtoe Ekzekutive në Iniciativen e Re Shoqërore*

Jovana Radosavljević është Drejtoe Ekzekutive në Iniciativën e Re Shoqërore. Ajo ka përvojë në monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë dhe mbështetjes së jashtme të fushatave paqësore në Serbi. Më parë ka punuar në OJQ-në 'Building Bridges Shift' Gjithashtu ka qenë gazetare dhe prezantuese në kanalin televiziv MIR.

Radosavljević është bursiste e programit TLP dhe ka përfunduar studimet Master në Studime Ndërkombëtare në Universitetin e Denverit, me specializim në zgjidhjen e konfliktit dhe zhvillimit ndërkombëtar



## **DARKO DIMITRIJEVIĆ**

*Kryeredaktor në Radio Gorazdevac*

Darko Dimitrijević është kryeredaktor në Radio Televizionin Gorazdevac (RTG). Para se të bëhej kryeredaktor, ai ishte gazetarë në RTG. Ai gjithashtu u zgjodh si anëtar i Bordit Ekzekutiv të Drejtorëve, të Shoqatës së Mediave të Kosovës. Z. Dimitrijević është korrespondent i shumë mediave në Kosovë.

Përveç punës si korrespondent, Z.Dimitrijević ka punuar gjithashtu si këshilltar për media në OJQ-në Qendra për të Drejtat e Komuniteteve pakicë, si dhe ka ndihmuar në hartimin e propozimeve për masat me marrëdhënien me publikun për media të ndryshme qendrore dhe lokale. Z. Dimitrijević ka përfunduar studimet për Gazetari në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti Ndërkombëtar i Novi Pazar.

## Fjalori i Disicon

*Informatat thelbësore për të kuptuar më mire çfarë është deformimi i informacionit*

**Shtrembërim i informacionit**<sup>2</sup> paraqitet në tre lloje të ndryshme: keqinformim, dezinformim dhe informim me qëllim të keq.

**Keqinformim** është kur shpërndahet informacion i pa saktë, mirëpo nuk ka për qëllim të shkaktoj dëm<sup>3</sup> **Keqinformim = informacion i pa saktë + gabim**

**Dezinformim** është kur shpërndahet informacion me qëllim që të shkaktoj dëm.<sup>4</sup> **Dezinformim = informacion i pavërtetë + qëllim për të shaktuar dëm**

**Informim me qëllim të keq** është kur shpërndahet informacion i vërtetë mirëpo që ka qëllim të shkaktoj dëm. Shpesh herë ky informacion është i destinuar për të qenë privat.<sup>5</sup> **Mal-information = informacion i vërtetë + qëllim për të shaktuar dëm**

**Robota (Bots)** janë llogari në rrjetet sociale të cilat operojnë përmes programve kompjuterike dhe janë të programuara që të krijojnë postime në rrjete sociale. Këto llogari mund të përdoren për shpërndarje të informacioneve mashtruese.<sup>6</sup>

## Verifikimi i burimeve vs. Verifikimi i fakteve

**Verifikimi i burimeve** është vlerësimi i burimit i cili fillimisht krijoi përmbajtjen ose së pari e ndau atë në mënyrë që të bëhet një vlerësim i kredibilitetit të informacionit.<sup>7</sup>

**Verifikim i fakteve** është vlerësim i fakteve në një shkrim të caktuar, apo në një artikull lajmesh, në një fjalim, etj. në mënyrë që të bëhet vlerësimi nëse faktet janë të sakta.<sup>8</sup>

---

<sup>2</sup>. Council of Europe. (2017) "Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policy making". <https://rm.coe.int/information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research/168076277c>

<sup>3</sup>. Council of Europe. (2017) "Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policy making". <https://rm.coe.int/information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research/168076277c>

<sup>4</sup>. Council of Europe. (2017) "Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policy making". <https://rm.coe.int/information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research/168076277c>

<sup>5</sup>. Council of Europe. (2017) "Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policy making". <https://rm.coe.int/information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research/168076277c>

<sup>6</sup>. Howard, P. N. & K. Bence (2016) Bots, StrongerIn, and Brexit: Computational Propaganda during the UK-EU Referendum, COMPROP Research note, 2016.1, <http://comprop.oii.ox.ac.uk/wp-content/uploads/sites/89/2016/06/COMPROP-2016-1.pdf>

<sup>7</sup>. Wardle, C. (2017). Information Disorder. 'Toward an interdisciplinary framework for research and policymaking'. <https://rm.coe.int/information-disorder-report-version-august-2018/16808c9c77>

<sup>8</sup>. Cambridge Dictionary



